



01/Nr. 934 2022
Data : 07.11.2022

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e dhjetë -X- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe financa , mbajtur me datë 18.10.2022 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetari i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë për Administratë), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim), **Sevime Luri** (Kryesuese e komisionit të aksionarëve të **N.P.L Pastrimi sh.a.**), Përfaqësuesi i OSB-së.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2022.
3. Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2023.
4. Kërkesa e kompanisë “Guri i Bekuar” për dhënien e pëlqimit për vendosjen e impiantit (fabrikës) për prodhimin e gurit gëlqeror.
5. Plotësim ndryshimi i rregullores për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit.
6. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
7. Raporti për vlerësimin e performancës së Komunës për vitin 2021.
8. Informatë e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2021/2022 në SHFMU dhe SHML.
9. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2022 i N.P.L Pastrimi sh.a.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- propozoj që pika e katërt të hiqet nga rendi i punës, sepse nuk ka nevojë të kaloj në Komitet për Politikë dhe Financa pasi që është në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
2. **Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2022.**
3. **Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2023.**
4. **Plotësim ndryshimi i rregullores për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit.**
5. **Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.**
6. **Raporti për vlerësimin e performancës së Komunës për vitin 2021.**
7. **Informatë e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2021/2022 në SHFMU dhe SHML.**
8. **Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2022 i N.P.L Pastrimi sh.a.**
9. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. **Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2022.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Sevdi Dernjani thekson: pasi që drejtoresha nuk është prezentë do ta prezantojë këtë pikë unë dhe nëse keni diçka tek raporti financiar do të ja përcjell drejtoreshës dhe në kuvend do të jep sqarime. Nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson: pasi që drejtoresha nuk është prezentë do t'i paraqes në kuvend por pasi që jemi këtu kërkoj me shkrim nga muaji qershor deri ne shtator mëditjet që janë procesuar te bashkangjitur dhe emrat dhe mbiemrat.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINACIARË PËR PERIU DHËN JANAR – SHTATOR 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2023

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Sevime Luri thekson:- Planin e biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a e keni pranuar si material dhe nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- tek mjetet 65,000 ishte një shumë bukur e madhe me duket që janë shumë mjete të ndara për kompaninë. Sa është realizuar inkasimi në kompani.

Sevime Luri thekson:- inkasimi i mjeteve është realizuar bukur shumë tek kompania edhe pasi që kompania i ka vendosur logot inkasimi ka qene jashtëzakonisht i mirë

Sherif Berisha thekson:- pasi që jemi në komision është mirë para se të planifikohen këto plane të njoftohemi edhe ne. Si komision gjithashtu kemi kërkuar edhe një auditim .

Sevdi Dernjani thekson:- tek planifikimi i mjeteve për kompaninë ka ndikuar edhe rritja e çmimeve si p.sh çmimi i naftës.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I BIZNESIT TË NPL PASTRIMI SH PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Plotësim ndryshimi i rregullores për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Hanit të Elezit .

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Arsim Dernjani thekson:- sa i përket plotësim ndryshimit të kësaj rregullore për deri sa mjeku ja lejon punën edhe pas pensionimit atëherë po që se kalon propozimi në kuvendë do të vazhdojnë të punojnë edhe pas pensionimit.

Sherfi Berisha thekson:- tek taksistët ka probleme p.sh nuk ka vend të posaçëm, disa janë edhe ilegale por nuk jam kundër kësaj pike.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLOTËSIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Sherif Berisha thekson:- Nëse ka mundësi me shumë informata rreth rekomandimeve të auditorit.

Sevdi Dernjani thekson:- kemi pasur nëntë të gjetura . Klasifikimi i shpenzimeve në kategorinë ekonomike jo përkatëse, Mangësi në shënimet shpjeguese të pasqyrave vjetore financiare, Parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit, Mangësi në vlerësimin e tenderëve, Parregullsi në procedurat e subvencionimit të projekteve, Nënshkrimi i kontratës publike pa zotim paraprak të mjeteve në SIMFK, Parregullsi në menaxhimin e pasurisë jofinanciare, Rritje e llogarive të farkëtueshme, Vonesa në regjistrim dhe pagesa të obligimeve.

Natyra Kalisi thekson:- Ky është raporti i periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit , dhe njëra nga këto të gjetura i përket drejtorisë sime që ka qene Parregullsi në menaxhimin e pasurisë jofinanciare ku kemi bere hulumtimin e të gjeture e kemi vërejt që në komunën ton sistemi i e pasurisë nuk është funksional do të thotë sistemi për hyrjen e daljen nga depo nuk ka qene i rregulluar qe dy vite dhe kjo është një e gjetur që është plotësisht e zbatuar .

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI PERIODIK LIDHUR ME PROGRESIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Raporti për vlerësimin e performancës së Komunës për vitin 2021

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Natyra Kalisi thekson :- është raporti për vlerësimin e performances për vitin 2021 dhe duhet shqyrtohet në Komitet për Politik e Financa. Në material e keni edhe raportin e të gjitha komunave Kosovës mirëpo e kemi bashkangjitur ne statistikat e fushave të caktuara. Shërbimet Publike Administrative **90.4** , Transparenca Komunale **72.2** , Përgjegjshmëria Komunale **52.2**, Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare **24.0**, Kulture,Rini, Sport **65.7**, Menaxhimi i fatkeqësive **50.0**, Planifikimi Hapësinor Komunal **50.3**, Hapësira Publike **70.9**, Infrastruktura Rrugore **62.6** , Transporti Publik **10.0**, Parkingjet Publike **14.1**, Uji i Pijshëm **75.5**, Kanalizimi **48.8**, Menaxhimi i Mbeturinave **75.9**, Mbrojtja e Mjedisit **66.7**, Përfaqësimi Gjinnor **35.1**, Arsim Parauniversitar **47.9** , Kujdesi Primar Shendetesor **46.9** , Zhvillimi Ekonomik Lokal **35.8**. Sipas njoftimeve janë vetëm gjashtë komuna fituese e grandit dhe ne si komunë nuk jemi fituese , do te mundohemi që gjate këtij vitit me rrit nivelin e performances.

Refet Kalisi thekson :- tek kanalizimet nuk pajtohem me këtë përqindje pasi që të gjitha kanalizimet janë të rregulluara.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI PËR VLERËSIMIN E PERFORMACËS SË KOMUNËS PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Informatë e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2021/2022 në SHFMU dhe SHML.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Hisni Luri thekson:- për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e pestë Ministria ka ekzekutuar shujta, përveç procesit të mësimit janë mbajtur edhe gara sportive regjionale dhe komunale, shëtitje një ditore, është mbajtur edhe testi i arritshmërisë ku nxënësit kanë arritur sukses të mira ndërsa tek testi i maturës vetëm 12 nuk kane arritur ta kalojnë testin e maturës. Sa i përket numrit të nxënësve nga para fillorët deri në klasës e 12 numri total ka qene 1779 nxënës . Klasa 1-5 suksesi ka qene 4.14 nga klasa 6-9 ka qene 3.56 ndërsa sa i përket shkollës se mesme mesatarja ka qenë 3.09 për me shume janë të paraqitura në material.

Sherif Berisha thekson :- kam një pyetje sa i përket nxënësve që kanë përsëritur dhe furnizimi me dru në shkolla.

Hisni Luri thekson:- sa i përket klasës se përsëritur kanë qene 35 të përsëritur ku 5 kane qene vajza. Për shkak se femrave nuk kemi mundur me i dërguar në shkollë profesionale pasi që nuk kemi shkollë tjetër të mesme sepse udhëzimi e potencon tek shkolla më e përafërt. Sa i përket shujtave prej 1-5 , drejtoria ka pas mjete të pa planifikuara dhe është dashur të ekzekutohen , nëse përsëri ministria do të dedikon mjete financiare në atë kod ne përsëri do të japim shujta, ndërsa sa i përket druve kanë premtuar që pas disa ditëve do të furnizohen.

Refet Kalisi thekson:- mjetet financiar në shumë 25,000 € a janë ekzekutuar ?

Hisni Luri thekson:- këto mjete janë shfrytëzuar për kifile për klasat 1-5.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATË E DKA-SË MBI SUKSESIN E ARRITUR PËR FUNDIN E VITIT SHKOLLOR 2021/2022 NË SHFMU DHE SHML QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Raporti financiar për periudhën Janar –Shtator 2022 i N.P.L Pastrimi sh.a.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Luri thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë pyetje mund të parashtroni.

U VOTU RAPORTI FINACIAR PËR PERIUdhËN JANAR –SHTATOR 2022 I NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Të ndryshme

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Sherfi Berisha thekson:- kërkoj përgjegjësi për pensionistët që kanë qenë në Elbasan sepse kam shumë ankesa nga qytetaret dhe pensionistët ?

Sevdi Dernjani thekson:- nuk është problem mundemi me ta paraqit si raport po pak a shumë mundem me të dhanë informatë për pensionistët kjo procedurë ka qenë me prokurim. Prokurimi ka hapur ofertat për transportin e pensionistëve nuk e dimë çka ka ndodhur mes kompanisë dhe prokurimit andaj prokurimi duhet kompanisë t'i jap një vërejtje dhe në vendosjen e sanksioneve për mos pagesën e transportit, fatkeqësisht ka ndodh edhe pse është kategori që nuk duhet ndodh por kompania ka pranuar fajin.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj përgjegjësi nga Kryetari ose Nënkryetari.

Sevdi Dernjani thekson :- mundemi me të përcjell edhe me shkrim, kompania i merr përgjegjësin e pasi që ne kemi dhenë procedurat sipas ligjit vendimi shkon ne prokurim pastaj prokurimi zgjedh kompaninë.

Kryesuesi thekson:- po flitet që kanë për të shkuar në Shqipëri 25 veta dëshiroj më shumë informata kush i dërgon?

Majlinda Kaloshi thekson:- ideja ka qenë për me i dërguar stafin e ri të komunës dhe ideja nuk ka rrjedh prej komunës por prej kompanisë Sharrcem është si një dhuratë nga kompania Sharrcem dhe ftesa është bërë për ekzekutivin dhe një pjesë të stafit por disa nuk kanë shprehur dëshirë të jenë në listë.

Refet Kalisi thekson:- te uji ku kanë arritur punimet.

Arsim Dernjani thekson:- problemi është tek KEDS-i sepse vetëm edhe pak ore kanë mbetur për tu vendosur.

Sherif Berisha thekson:- është një shqetësim tek Lagja e Vileve që rruga të shtrohet me asfalt kisha kërkuar përgjigje nga Nënkryetari.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:30 .

Procesmbajtësja
Sara Berisha

